



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:116931
Datë: 12.10.2020
Numri i dokumentit: 01178288
C.nr.210/17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, punëtore e kësaj gjykate, duke vendosur në çështjen juridike të paditësve M.G dhe H.G , qe te dy nga fshati. ... Komuna Kaçanik, të cilit me autorizim i përfaqëson avokat Flamur Troni nga Kaçaniku, kundër të paditurës Komuna e Kaçanikut të cilin me autorizim e përfaqëson Ilir Lumi, për çështjen kontestuese Vërtetimi i pronësisë, në seancën kryesore të mbajtur me datën 05.10.2020, në praninë e paditësit H. G. dhe të autorizuarëve të palëve ndergjyqjese, ndërsa me datën 08.10.2020, bëri përpilimin me shkrim :

A K T G J Y K I M

I.REFUZHET kërkespadi e paditësve M. G. dhe H. G. nga fshati. ..., Komuna e Kaçanikut, me të cilën kan kërkuar vërtetimin e të drejtës së bashkëpronisës, të një pjese të ngastrës kadastrale ..., në vendin e quajtur “K...”, me kulturë arë e klasës 4 , në sipërfaqe prej ... Z.K. N..., e evidentuara në certifikatën e pronës ..., në tersi SI E PA BAZUAR.

II.Secila palë i përballon shpenzimet e krijuara.

A r s y e t i m

Paditësi për mes të autorizuarit, si në padi ashtu edhe në seancat gjyqësore, kan kërkuar nga gjykata qe kërkesëpadi e paditësve të miratohet në tësrsi si e bazuar dhe të vërtetohet se paditësit janë bashkëpronar, të një pjese të ngastrës kadastrale ..., në vendin e quajtur “K...” , me kulturë arë e klasës 4 , në sipërfaqe prej ... ZK. N... , e evidentuara në certifikatën e pronës me numër të lëndës

I autorizuar ka theksuar se në këtë pjesë të ngastrës paraardhësit e tyre e kanë fituar pronësin në bazë të aktgjykimit C.nr.915/76 të dates 11.06.1979, sepse kjo pjesë e kësaj ngastre me operatin e vjetër kadastrale ka qen prone e tyre, ndërsa me aëroinqizim ka kaluar në emërë të të paditurës, e këty fakt është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarve F. Guri, D. D. dhe K.

V., tani të ndjerë dhe ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë e viti 1979, nga të cilat prova është vërtetuar se kjo pronë ka qenë e tyre.

Po ashtu kanë thekësuar se paraardhësi dhe paditësit e kanë pasur dhe e kanë në posedim këtë pjesë të ngastrës, të njëjtën e punojnë të pa penguar nga askush e as nga të paditurit dhe në të njëjtën e kanë fituar pronësinë me parashkrim fitues konform nenit 40 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

I autorizuari i të paditurës si në përgjegjësi në padi, ashtu edhe gjatë shqyrtimeve të mbajtura gjyqësore kërkesëpadinë e paditësit e ka kontestuar në tërësi si të pa bazuar dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzoj.

Ka thekësuar se ngastra kadastrale ..., ZK N..., evidentohet si prone shoqërore Komuna e Kaçanikut, ky fakt vërtetohet nga Çertifikata e pronës . Po ashtu kanë thekësuar se gjatë këti procesi gjyqësor nuk kanë prezentuar asnjë faktë se këtë parcelë e kanë trashiguar nga paraardhësit e tyre, pastaj nuk kanë prezentuar prova se e kanë paguar tatimin në prone ashtu siqë ka qenë me Ligjin Themelor për shfrytëzimin e tokës Bujqësore.

Po ashtu ka thekësuar se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e në veqanti nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë dhe historiati i parcelës , vërtetohet se kjo ngastër nuk ka qenë prone e paditësve por ka qenë prone shoqërore.

Meqëse kjo pjesë është pasuri shoqërore , fakt i vërtetuar nga çertifikata e pronës , paditësit në të njëjtën nuk mundë ta fitojnë pronësinë sepse me neni 29 të Ligjit mbi Mardhënjet Themelore Juridiko Pronësore, është parapar se pronësia nuk mundë të fitohet në sendin në pronësi shoqërore me parshkrim fitues.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjenden faktike në këtë çështje kontestimore gjykata bëri administrimin e këtyre provave: u lexuan aktgjykimi C.nr 915/76, kopja e planit, Aktvendimi Ac.nr.747/79, Aktvendimi C.nr. 116/81, përgjegjja në padi, çertifikata e pronës, ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, harta kadastrale, Aktvendimi për trashigim. Proceverbali I datës 22.05.1979 pa pyetje dhe pa vërejtje.

Gjykata pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegjësi të secilës provë veq e veq dhe të gjithave bashkarisht e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të LPK-së, dhe bindjes së lirë të kësaj gjykate, kjo gjykatë lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko-civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Prona kontestuese në shërbimin e gjeodezisë evidentohet si pasuri shoqërore, një pjesë të kësaj ngastre paditësi e kanë në shfrytëzim. Paditësi me asnjë provë nuk e kanë vërtetuar se

kjo ngastër ka qen e paraardhësve të tyre , paditësit në këtë pjesë nuk e kanë fituar të drejtën e pronësisë sepse kemi të bëjmë me pronë shoqërore dhe në pasurin shoqrore pronësia nuk fitohet me parashkrim fitues.

a) Se kjo pjesë e pronës kontestuse në shërbimin e gjeodezisë evidentohet si pasuri shoqërore, këtë fakt Gjykata e vërtetoi nga certifikata e pronës me numër të lëndës ..., Po ashtu këtë fakt gjykata e vërtetoi edhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, në të cilën është konstatuar se ngastra kadastrale 298-0, në vendin e quajtur “K...” , me kulturë arë e klasës 4, ZK. N..., evidentohet si pasuri shoqërore, P.SH Kuvendi Komunal Kaçanik.

b)se një pjesë të kësaj ngastre paditësit e kanë në shfrytëzim, këtë fakt Gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, i cili në ekspertizën e tij ka konstatuar se paditësit një pjesë të kësaj ngastre në sipërfaqe prej 1264m², e cila në hartën kadastrale është paraqitur me ngjyrë të portokallte, e kanë në shfrytëzim dhe të njëjtën e kanë të rrethuar me shtylla druri dhe një pjesë është me kulturë arë ndërsa një pjesë ca më e vogël është me kulturë livadhe.

c) Paditësi me asnjë provë nuk e kanë vërtetuar se kjo pjesë e pasurisë të cilën e kërkojnë ka qenë pronë e paraardhësve të tyre , këtë fakt gjykata e vërtetoi nga thënjet në padi, theksimet e bëra gjatë seancave gjyqësore. Gjatë tërë këtij procesi gjyqësor paditësit nuk kanë prezantuar asnjë provë me të cilën do ta vërtetonin se kjo pjesë ngastrës kadastrale ka qen e tyre , nuk kanë prezantuar asnjë aktvendim mbi trashëgiminë ose ndonjë provë tjetre me të cilën do ta vërtetonin se kjo pronë ka qen e tyre.

d) Paditësi në këtë pjesë nuk e kanë fituar të drejtën e pronësisë sepse kjo pjesë është pasuri shoqërore dhe në të njëjtën nuk fitohet pronësisë me përshkrim fitues . Me neni 29 të Ligjit për Mëdhenjtë Themelore Juridiko Pronësore është paraparë se mbi sendi në pronësi shoqërore nuk fitohet pronësia me përshkrim fitues.

Gjykata pas analizimit të thënieve në padi theksimeve të bëra gjatë seancave gjyqësore, kërkesëpadinë e paditësit e refuzoi si të pa bazuar. Gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e palës paditëse sepse e njëjta me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se kjo pron ka qen e paraardhësve të paditësve. Pala paditëse gjatë këtij procesi gjyqësor nuk ka prezentuar asnjë provë me të cilën do ta vërtetonte bazën e kërkesëpadisë.

Nga provat të cialt gjnden në shkresat e lëndës edhe atë nga ekspertizat e punuar në lëndës C.nr 915/76, ku është konstatuar se kjo ngastre ka qen pasuri shoqërore. Po ashtu edhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë Milazim Salihaj vërtetohet se kjo ngastër në vitin 1958, është evidentuar si pasuri shoqërore P.SH Kuvendi Komunal në Kaçanik Gjykata po ashtu e refuzoi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit sepse paditësit nuk e kanë fituar pronësinë sepse kemi të bëjmë me pasuri shoqërore dhe në të njëjten pronësia nuk fitohet me parashkrim fitues konform neni 29 të LMTHJP.

Gjykata e refuzoi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve, sepse paraardhësit e paditësve kanë pasur mundësi që ti paraqesin vërejtjet me rastin e aeroinqizimit dhe klasifikimit të parcelave, sepse ky regjistrim ka qenë në debat publik në vitin ..., Paditësit gjatë asaj kohe nuk kanë paraqitur vërejtjet lidhur me shënimet e regjistruara, nuk janë ngarkuar me tatim në të ardhura kadastrale qysh prej hyrjes në fuqi të operatit të ri kadastral.

Prandaj gjykata duke i pasur për bazë këto fakte se paditësit me asnjë provë nuk e kanë vërtetuar bazën e kërkesëpadisë, nuk kanë paraqitur vërejtje lidhur me regjistrimin në operatin e ri kadastral dhe konform nenit 29 LMTHJP, e refuzoi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse, e cila i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë ta miratoi në tërësi si të bazuar, këtyre theksimeve gjykata nuk u'a dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata e refuzoi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve sepse paditësit me asnjë provë nuk e kanë vërtetuar bazën e kërkesëpadisë. Nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës është vërtetuar se kjo ngastër ka qenë dhe është pronë shoqërore ky fakt është vërtetuar nga ekspertizat e ekspertve të gjeodezisë dhe nga historiat e parcelës, prandaj gjykata vendosi si më lartë.

Gjykata i analizoi edhe pretendimet e paditësve se të njëjtit pronësin e kanë fituar me aktgjykimin C.nr.915/76., por këto theksime nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes, sepse ky aktgjykim nuk është i formës së prerë sepse është prishur me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr. 747/79, të datës 27.02.1980 dhe qështja është kthyer në rigjykim dhe pasataj padia e paditësit është konsideruar e tërhequr.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të autorizuarit të të paditurës, i cili i propozoj gjykatën që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar, sepse paditësit me asnjë provë nuk e kanë vërtetuar se në këtë pjesë të ngastër kadastrale e kanë fituar pronësin. Këtyre theksimeve gjykata u'a dha besimin sepse paditësit me asnjë provë nuk e kanë vërtetuar se në këtë pjesë e kanë fituar pronësin. Ndërsa nga ekspertizat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, historiat e parcelës, vërtetohet se kjo ngastër ka qenë dhe është pasuri shoqërore dhe në të njëjtën nuk fitohet pronësia me parashkrim fitues.

Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës vendosi që secila palë ti përballon shpenzimet e krijuara, duke e pasur për bazë suksesin në procedurë dhe konform neni 451. të LPK-së.

Dega në Kaçanik,
C.nr.210/17 prej datës 05.10.2020

Gjyqtari
Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE:

kundër këtij aktgjykimi pala e pa knaqur ka të drejtë të paraqes ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtijë aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Expeduar me datën 12.10.2020

1x1Padiësit

1x1Të paditurës